

Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

## RAPORT

### I

## MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS PËR VIZITËN NË QENDRËN KORREKTUESE NË DUBRAVË

**Për:** Znj. Albulena Haxhiu, ministre  
Ministria e Drejtësisë

Z. Arben Vitia, ministër  
Ministria e Shëndetësisë

**Kopje:** Ismet Krasniqi, sekretar i përgjithshëm  
Kuvendi i Republikës së Kosovës

Z. Nehat Thaqi, drejtor i përgjithshëm  
Shërbimi Korrektues i Kosovës

Z. Milazim Gjocaj, drejtor  
Departamenti Shëndetësor në Burgje

Z. Samedin Mehmeti, drejtor i përgjithshëm  
Policia e Kosovës

Z. Ismail Dibrani, drejtor  
Qendra Korrektuese në Dubravë

Z. Habit Hajredini, drejtor  
Zyra e Kryeministrit - Zyra për Qeverisje të Mirë

Prishtinë, më 22 prill 2021

## HYRJE

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17 të Ligjit nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës vizitoi Qendrën Korrektuese në Dubravë.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës (më tej: MKPT), bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, mund t'i vizitojë, në çdo kohë dhe pa paralajmërim, të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë stacionet policore, qendrat e paraburgimit, burgjet, vendet ku mbahen të huajt e privuar nga liria, qëndrimi i të cilëve në Republikën e Kosovës bie ndesh me ligjet në fuqi dhe të cilët janë subjekt i kthimit me forcë nga Republika e Kosovës, si dhe institucionet psikiatrike dhe ato të kujdesit social.

Bazuar në këtë mandat, MKPT-ja, nga data 23 deri më 26 shkurt 2021, e ka vizituar Qendrën Korrektuese në Dubravë (më tej: QKD).

Objektivi i kësaj vizite ishte vlerësimi i respektimit të të drejtave themelore të njeriut të të burgosurve, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, si dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria.

### **Bashkëpunimi me MKPT-në gjatë vizitës**

1. Gjatë vizitës së MKPT-së të realizuar në QKD, personeli i shërbimit korrektues dhe personeli i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve (më tej: DShB) i ofruan ekipit monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipi, pa vonesa, pati qasje në të gjitha vendet që i ka vizituar. Ekipit i janë siguruar të gjitha informatat e nevojshme për ta kryer detyrën dhe i janë mundësuar bisedat me personat e dënuar dhe me të paraburgosur, pa praninë e zyrtarëve korrektues dhe as të personelit shëndetësor.

### **Njoftimi i të burgosurve për të drejtat e tyre**

2. Neni 31, paragrafi 2, i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (më tej: LESP), përcakton shprehimisht: "*Me rastin e pranimit në institucionin korrektues, personi i dënuar njoftohet me shkrim për të drejtat dhe detyrimet që i ka gjatë mbajtjes së dënimit. Personi i dënuar i cili nuk dinë shkrim dhe lexim njoftohet gojarisht.*" MKPT-ja ka vërejtur se në krahët e pavijoneve janë të vendosura njoftime të ndryshme për të drejtat e të burgosurve. Po ashtu, në të gjitha pavijonet e QKD-së, MKPT-ja ka vërejtur se janë vendosur njoftime të qarta për ndihmë juridike falas ku janë vendosur numra telefoni dhe njoftime të tjera, nga të cilat mund të përfitojnë të burgosurit.

### **Keqtrajtimi fizik**

3. Gjatë vizitës në këtë qendër, MKPT-ja nuk mori ankesa të besueshme për keqtrajtim fizik apo për përdorim të tepruar të forcës fizike nga zyrtarët korrektues. MKPT-ja ka vërejtur se niveli i komunikimit interaktiv ndërmjet zyrtarëve korrektues dhe të të burgosurve ishte në nivel shumë të kënaqshëm.
4. Ekipi monitorues, gjatë vizitës i intervistoi të paraburgosurit e akomoduar në QKD, për të kuptuar më shumë lidhur me trajtimin e tyre nga policia e Kosovës dhe për respektimin e

të drejtave të tyre themelore, që nga momenti i arrestimit. Të gjithë të paraburgosurit e intervistuar kanë pohuar se janë trajtuar në mënyrë korrekte dhe profesionale nga policia e Kosovës dhe se të drejtat e tyre themelore janë respektuar.

### **Ankesat për korrupsion dhe favorizime**

5. MKPT-ja ka pranuar pohime nga të burgosurit për korrupsion dhe favorizime, që përfshijnë jo vetëm personelin korrektues, por edhe personelin shëndetësor. Sipas këtyre pohimeve, bazuar në një pagesë të caktuar të parave apo në ndonjë mënyrë tjetër, të burgosurit mund të përfitojnë trajtim favorizues sa u përket mundësive për të punuar, vizitave familjare, largim të përkohshëm jashtë institucionit, trajtim mjekësor etj. MKPT-ja po ashtu ka pranuar një numër të pohimeve nga të burgosurit, sipas të cilëve, të burgosurit e caktuar të kategorive të caktuara trajtohen me favorizime krahasuar me të burgosurit e tjerë.
6. Lidhur me këto pretendime, drejtoria e QKD-së e ka njoftuar MKPT-në si në vijim: *“Ne në vazhdimësi kemi bashkëpunuar me Policinë e Kosovës për disa raste të izoluarra me çka edhe kemi ndërmarr hapa deri në largimin nga puna. Kemi edhe disa raste të të dyshuarve në përfshirje në korrupsion për çka jemi duke punuar shumë ngushtë me policinë e Kosovës.”*
7. Edhe përmes këtij raporti, MKPT-ja, duke mos paragjykuar nëse pohimet e tilla janë të vërteta apo jo, konsideron se drejtoria e QKD-së dhe organet kompetente të Shërbimit Korrektues të Kosovës (më tej: ShKK) duhet të zhvillojnë hetime gjithëpërfshirëse dhe të pavarura sa herë që ka pohime për korrupsion dhe favorizime në QKD. Autoritetet në fjalë duhet t'i forcojnë përpjekjet e tyre për t'i luftuar këto fenomene përmes masave parandaluese, edukimit dhe aplikimit të sanksioneve adekuate.

### **Kushtet materiale**

#### **Ushqimi**

8. MKPT-ja vëren se LESP-ja përcakton se i dënuari ka të drejtë për ushqim të përshtatshëm për ruajtjen e mirë të shëndetit dhe të fuqisë së tij, në tri shujta për çdo ditë, të cilat duhet të jenë të llojllojshme dhe ushqyese. Ushqimi që i jepet personit të dënuar duhet t'i përshtatet moshës dhe gjendjes së tij shëndetësore, natyrës së punës, stinës e kushteve klimatike dhe, për aq sa është e mundur, duhet t'i përshtatet kërkesave të tij fetare dhe kulturore. Më tej ligji përcakton obligimin që të dënuarit t'i sigurohet ushqimi i caktuar nga mjeku.<sup>1</sup>
9. MKPT-ja vëren se edhe Rregullat e Mandelës përcaktojnë obligimin e autoriteteve që të burgosurve t'u sigurojnë ushqim adekuat për shëndetin e tyre, si dhe ujë të pijshëm gjatë gjithë kohës.<sup>2</sup> Në këtë drejtim, Rregullat Evropiane të Burgjeve përcaktojnë obligimin e autoriteteve që të burgosurve t'u sigurojnë ushqim dietal, duke pasur parasysh moshën e tyre, gjendjen e tyre fizike, religjionin dhe natyrën e punës së tyre. Ushqimi duhet të përgatitet dhe të shërbehet në kushte adekuate higjienike, kurse uji i pijshëm duhet të jetë

<sup>1</sup> Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 39, paragrafët 1 dhe 2.

<sup>2</sup> Rregullat e Mandelës, Rregulli 22.

në dispozicion gjatë gjithë kohës.<sup>3</sup> MKPT-ja mori një numër të konsiderueshëm të ankesave lidhur me cilësinë dhe sasinë e ushqimit.

10. Kontrollin e ushqimit e bën shërbimi shëndetësor duke i marrë mostrat, të cilat monitorohen për 72 orë, si dhe përkujdesen për cilësinë e ushqimit duke u bazuar në menynë ditore – javore dhe ushqimin dietal. Më 24 mars 2021, MKPT-ja ka kërkuar komentet e DShB-së lidhur me ankesat e të burgosurve për cilësinë dhe sasinë e ushqimit i cili u shërbehet.
11. DShB-ja, më 25 mars 2021, e njoftoi MKPT-në se kuzhina inspektohet nga mjeku dhe çdo ditë merren mostrat e ushqimit dhe ruhen në vend të sigurt. Më tej në këtë njoftim theksohet: *“Sa i përket cilësisë së ushqimit, ka pasur raste kur mjeku ka bere raport dhe është kërkuar rritje e cilësisë, mirëpo e rëndësishme mbetet kushtet e ruajtjes së ushqimit, higjiena, servimi dhe ruajtja e mostrave gjë që përcjellët në vazhdimësi dhe mund të themë që deri me tani nuk kemi pasur helmime në mase në Institucion për shkak të ushqimit.”*
12. MKPT-ja ka vërejtur se bazuar në rekomandimin e mjekut, 9 të burgosur duhet të marrin ushqim dietal. MKPT-ja, përmes kontrollit të dokumentacionit, ka vërejtur se të burgosurve u ofrohet ushqimi dietal sipas rekomandimit të mjekut.

#### **Kuzhina e QKD-së**

13. Gjatë vizitës në kuzhinë, MKPT-ja ka vërejtur se janë të angazhuar në punë 2 kuzhinierë dhe 15 deri në 20 të burgosur. Të angazhuarit në kuzhinë, përfshirë këtu edhe të burgosurit, nuk janë të pajisur me librezë sanitare, gjë që për MKPT-në përbën shqetësim serioz. MKPT-ja ka vërejtur se pajisjet në kuzhinë janë shumë të vjetruara, afërsisht 20 vjet dhe shpesh kanë probleme teknike, disa pajisje në kuzhinë janë jashtë funksionit. MKPT-ja gjithashtu ka vërejtur me shqetësim se në kuzhinë nuk ka mjaftueshëm dezinfektues dhe dorëza. Personeli i kuzhinës vlerëson se, duke pasur parasysh se brenda ditës në këtë kuzhinë përgatiten 1000 shujta, është e nevojshme rritja e numrit të personelit.
14. MKPT-ja ka vërejtur se depoja ku mbahet ushqimi afatgjatë ishte në gjendje të mirë dhe i ka kushtet që nevojiten për ruajtje të ushqimit dhe nuk ka lagështi. Nuk janë gjetur produkte me afat të skaduar. Gjatë vizitës në depo, MKPT-ja ka vërejtur se mënyra se si e përdorin ashensorin paraqet rrezik nga rryma. Lidhur me gjendjen e ashensorit dhe mënyrën e përdorimit, më 9 mars 2021, ka kërkuar komentet e drejtorit të QKD-së. Sipas drejtorit, ky lloj lifti është model i vjetër dhe nuk ka pjesë në treg për këtë model. Zyra e mirëmbajtjes është në përpjekje për ta modifikuar në mënyrë që të mos rrezikohet stafi dhe të dënuarit. Për më shumë, sipas drejtorit, sistemi është i pajisur me një aparaturë e cila tensionin 220 voltë e shndërron në 12 voltë dhe në këtë mënyrë nuk përbën rrezik për jetën e njeriut.
15. MKPT-ja ka vërejtur se në hapësirën që përdoret për lavanteri ka rrjedhje uji nga taveri. Sipas të burgosurit, i cili ishte i angazhuar në punë, uji i cili pikon është nga banjat. MKPT-ja u informua se vetëm 2 makina janë në funksion, të tjerat ishin jashtë funksionit. Në përgjithësi, MKPT-ja u njoftua nga personeli se gjendja teknike është jo e mirë,

---

<sup>3</sup> Rregullat Evropiane të Burgjeve, Rregullat 22.1 deri 22.6.

makineritë prishen shpesh dhe si pasojë nganjëherë pastrimi bëhet me ujë të ftoftë. Po ashtu, MKPT-ja u njoftua se nuk ka mjaftueshëm dezinfektues dhe dorëza. MKPT-ja konsideron se autoritetet kompetente duhet t'i rrisin përpjekjet e tyre për t'i mënjeluar këto mangësi, sidomos duke pasur parasysh se pandemia COVID-19 ende është e pranishme në vend.

16. Lidhur me këtë gjendje, më 23 mars 2021, MKPT-ja, përmes një shkrese zyrtare, ka kërkuar nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës që t'ia dërgojë MKPT-së raportin e fundit të inspektimit në QKD. Agjencia në fjalë, raportin e inspektimit në QKD e dërgoi te MKPT-ja, më 31 mars 2021. Ky raport është nga viti 2019.
17. Gjetjet në raport përbëjnë shqetësim serioz sa i përket gjendjes teknike të pajisjeve, mungesës së dezinfektuesve, rregullimeve të ndryshme teknike të cilat duhet të kryhen, të cilat duhet të evitohen, në mënyrë që të zbatohen rekomandimet e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës. MKPT-ja inkurajon autoritetet kompetente që t'i ndërmarrin veprimet konkrete për të evituar mangësitë e vërejtura nga MKPT-ja gjatë vizitës dhe të zbatohen rekomandimet e Agjencisë së Veterinës dhe Ushqimit.

### **Kushtet e akomodimit**

18. Kushtet e akomodimit dallojnë nga pavijoni në pavijon. MKPT-ja ka vërejtur se numri i të burgosurve u reduktua dukshëm për shkak të pandemisë COVID-19. Kështu, gjatë vizitës ishin të pranishëm 572 të burgosur, ndërsa kapaciteti zyrtar i QKD-së është 1030. MKPT-ja përshëndet veprimet e tilla të autoriteteve kompetente për të reduktuar numrin e të burgosurve. Veprime të tilla janë në pajtim me rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe të organizatave të besueshme ndërkombëtare, siç janë KPT-ja<sup>4</sup> dhe Nën-Komiteti i OKB-së për Parandalim të Torturës.<sup>5</sup>
19. Kushtet e akomodimit në përgjithësi mund të konsiderohen në pajtim me LESP-në dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve, përveç në pavijonet 2, 3 dhe 5, ku MKPT-ja ka vërejtur se janë të nevojshme rinovime të caktuara, ndërsa në disa qeli kishte depërtuar lagështia, kurse në Pavijonin 1 kishte qeli tualetet e të cilave nuk kishin ujë dhe kështu të burgosurit detyroheshin të shkonin në tualetin kolektiv, që nënkupton se sa herë që donin të shkonin në tualet kolektiv, duhej t'i thërrisnin zyrtarët korrektues që t'ua hapnin derën. MKPT-ja konsideron se autoritetet kompetente duhet të ndërmarrin veprime të menjëhershme për t'i mënjeluar këto mangësi.
20. Po ashtu, në raste të caktuara MKPT-ja mori disa pohime nga të burgosurit se mungonte uji i ngrohtë (pavijonet 1, 2, 3, dhe 5). Mirëpo MKPT-ja po ashtu ka marrë pohime nga të burgosurit e tjerë se ka ujë të ngrohtë dhe mund të bëjnë dushe sipas rutinës së përcaktuar.

---

<sup>4</sup>Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Deklarata e Parimeve Lidhur me Trajtimin e Personave të Privuar nga Liria në Kohë Pandemie COVID-19, publikuar më 20 mars 2020, Strasburg. Për më shumë shih në: <https://www.coe.int/en/web/cpt/-/covid-19-council-of-europe-anti-torture-committee-issues-statement-of-principles-relating-to-the-treatment-of-persons-deprived-of-their-liberty->

<sup>5</sup>Nën-Komiteti i OKB-së për Parandalim të Torturës, Këshillë për Palët Nënshkruese të Protokollit Fakultativ dhe Mekanizmat Kombëtarë Parandalues lidhur me pandeminë COVID-19, miratuar më 25 mars 2020. Shih në: <https://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/Advice%20of%20the%20Subcommittee%20on%20Prevention%20of%20Torture%20to%20States%20Parties%20and%20National%20Preventive%20Mechanisms%20relating%20to%20the%20Coronavirus%20Pandemic%20%28adopted%20on%2025th%20March%202020%29.pdf>

21. Gjatë vizitës, MKPT-ja u ka kushtuar vëmendje të veçantë të burgosurve, të cilëve u ishte shqiptuar masa disiplinore e vetmisë, për shkak të shkeljeve disiplinore. MKPT-ja vëren se LESP-ja përcakton se dhoma për ekzekutimin e masës disiplinore të vetmisë duhet të ketë një hapësirë prej së paku dhjetë (10) metrash kub, pajisje sanitare, dritë natyrore, ujë të pijshëm, shtrat me çarçaf, tavolinë, karrige dhe ngrohje.<sup>6</sup>
22. Po ashtu, Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (në tekstin e mëtejshëm: KPT), lidhur me kushtet e akomodimit në qeli ku mbahet i burgosuri, të cilit i shqiptohet masa disiplinore e vetmisë, thekson se qelitë e tilla duhet t'i plotësojnë standardet e njëjta minimale, si ato të cilat zbatohen në rastet e vendosjes së të burgosurve të tjerë. Ato duhet të jenë të madhësisë adekuate, të kenë dritë natyrore, të kenë ngrohje adekuate dhe të kenë ventilim. KPT-ja më tej thekson se qelitë e tilla duhet të jenë së paku të pajisura me tavolinë, me karrige adekuate, me krevat adekuat dhe me çarçaf.<sup>7</sup>
23. MKPT-ja ka vërejtur se kushtet e vendosjes në këto qeli janë në pajtim me standardet e përcaktuara me LESP-ja dhe me standardet e përcaktuara nga KPT-ja.<sup>8</sup>
24. Gjatë vizitës sërisht është vërejtur se të burgosurit përdorin pajisje elektrike të improvizuara për ngrohje të ujit, të cilat mund t'i rrezikojnë seriozisht jetët e tyre. Sipas pohimeve të të burgosurve, në mungesë të ujit të ngrohtë, ata detyrohen të përdorin pajisje të tilla të improvizuara.
25. MKPT-ja ka vërejtur se të burgosurit në përgjithësi janë furnizuar me dyshekë të rinj dhe batanije, si dhe me çarçafë, gjë që në të kaluarën përbente problem serioz, pasi dyshekët e mëparshëm ishin të cilësisë së dobët dhe me lagështi. Megjithatë, MKPT-ja ka hasur në raste kur të burgosurit ende nuk ishin furnizuar me dyshekë, çarçafë dhe batanije. Lidhur me këtë, MKPT-ja aty për aty e ka shprehur shqetësimin tek zyrtarët kompetentë, të cilët e njoftuan MKPT-në se nuk mungojnë furnizimet në këtë drejtim dhe se kjo mangësi do të mënjanohet sa më shpejt.

## Regjimi

26. Sa i përket regjimit, MKPT-ja, bazuar në dokumentacionin relevant, ka vërejtur se janë rreth 262 të burgosur të angazhuar në punë. Angazhimi në punë është më i madh gjatë stinës së verës. Zakonisht të dënuarit angazhohen për punë në kuzhinë, për pastrim dhe në ferma të QKD-së. Në kuadër të QKD-së funksionon edhe shkolla e mesme, në të cilën mësimin e vijnë 35 nxënës në tri klasa. Të dënuarit mund të lëviznin të lirë brenda pavijoneve ku ishin të vendosur dhe kanë të drejtë për 3 orë shëtitje në ditë gjatë stinës së verës, kurse gjatë dimrit, deri në 2 orë në ditë.<sup>9</sup>
27. Gjithashtu, në kuadër të QKD-së funksionojnë tri punëtori, të cilat në fakt janë edhe qendra për trajnime profesionale, ku organizohen trajnime për saldim, për ndërtimtari, për axhustator, për zdrukthëtari, për mirëmbajtje teknike, për instalim të ujit dhe për instalim

<sup>6</sup> Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 111, paragrafi 2.

<sup>7</sup> Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Pjesë nga raporti i 21-të i Përgjithshëm, publikuar në vitin 2011, për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806cccc6>, (21.5.2018).

<sup>8</sup> Standardet e KPT-së lidhur me kushtet e akomodimit për të burgosurit, të cilëve u shqiptohet masa disiplinore e vetmisë, janë përcaktuar përmes raportit të 21-të të Përgjithshëm. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806cccc6>.

<sup>9</sup> Sipas nenit 37 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, të dënuarit kanë të drejtë për së paku dy orë shëtitje.

të rrymës. Në këto punëtori organizohen kurse, me kohëzgjatje prej tre muajsh. Në përgjithësi, MKPT-ja gjatë vizitës ka vërejtur se angazhimi në punë, në aktivitete, në trajnime profesionale etj., i të burgosurve është më i madh krahasuar me periudhën e mëhershme dhe se në këtë drejtim është shënuar progres.

28. Në kuadër të QKD-së, në dispozicion të të burgosurve është salla e fitnesit dhe fusha e futbollit. Salla e sportit, për shkak të COVID-19, deri në një vendim tjetër, nuk mund të përdoret.
29. Për shkak të COVID-19, të burgosurit të cilët gëzojnë të drejtën për fundjavë apo për përfitime të tjera të cilat nënkuptojnë daljen nga QKD-ja, me t'u kthyer në QKD, i nënshtrohen qëndrimit në karantinë për 7 ditë.

### **Kujdesi shëndetësor**

30. Në QKD funksionon spitali i burgut, i cili ofron shërbime mjekësore për të burgosurit, në të cilin janë të angazhuar gjashtë mjekë të përgjithshëm të rregullt, 26 infermierë, 4 nga ta janë të angazhuar vetëm në ndërrimin e natës (12 orësh), kurse 4 të tjerë në ndërrimin e ditës (12 orësh), të tjerët janë të angazhuar me orar të rregullt nga ora 08:00-16:00, një psikolog me orar të rregullt, një fizioterapeutike, e cila tash për tash është në pushim të lehonisë dhe zëvendësohet nga një fizioterapeutik me gjysmë orari (4 orësh).
31. Varësisht nga vlerësimi dhe nevojat, spitali i burgut mbështetet nga institucionet e tjera publike shëndetësore, siç janë: Spitali Rajonal i Pejës, Emergjencia dhe Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) në tërësi. Janë 11 specializantë të ndryshëm, të cilët janë pjesë e konsultimeve të cilat ofrohen. Po ashtu në dispozicion të spitalit janë pulmologu, radiologu, kirurgu i përgjithshëm, fiziatri, tekniku i fizioterapisë, neurologu, urologu, ORL, oftalmologu, dermatologu, tekniku i radiologjisë.
32. Transporti i të burgosurve në institucione të tjera shëndetësore dhe anasjelltas bëhet me ambulancë të shërbimit shëndetësor, e cila është e pajisur me të gjitha pajisjet e nevojshme dhe me personel të nevojshëm.
33. MKPT-ja ka vërejtur se sëmundjet më të shpeshta janë: sistemi lokomotor (172 raste), sistemi gastrointestinal (139 raste), sindromave neurotike (129 raste), sindromave psikotike (105 raste), sëmundje kardio-vaskulare, sëmundje të lëkurës dhe të sistemit respirator (116 raste) etj. Sa i përket grupeve LGBT, MKPT-ja ka vërejtur se nuk ka të identifikuar nga autoritetet, respektivisht, asnjë i burgosur nuk u deklarua se i takon kësaj kategorie.
34. MKPT-ja ka vërejtur gjatë vizitës se në Repartin Psikiatrik të spitalit të QKD-së janë të shtrirë 8 persona nën përkujdesje përhershme, kurse dy në Pavijonin 7, të cilët janë të menaxhueshëm dhe nuk kanë nevojë për shtrirje spitalore. Bazuar në statistikat e shërbimit shëndetësor, 41% e të burgosurve përdorin terapi psikiatrike. Trajtimi psikiatrik përputhet në përgjithësi me terapinë e përshtuar nga psikiatri, por jo edhe me aktivitetet psiko-sociale.
35. Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur se në Repartin Organik është i vendosur një pacient me aftësi të kufizuara, i vendosur vetëm në një dhomë e cila aspak nuk i plotëson kushtet për një person të tillë. Bazuar në këtë gjetje, MKPT-ja gjatë vizitës ka rekomanduar që

personi në fjalë të transferohet në një dhomë tjetër, e cila i plotëson kushtet për akomodim dhe që në atë dhomë të vendoset edhe një person tjetër.

36. Në Repartin Psikiatrik, MKPT-ja ka vërejtur se është i vendosur pacienti U. K., i cili gjatë vitit 2020 u vetëlëndua disa herë, ndërsa në vitin 2021 dy herë. Gjatë intervistimit është vërejtur se i njëjti shpesh ka në dhomë mjete (ushqime - konserva) të cilat mund të përdoren për vetëlëndim apo lëndim të personit tjetër. Bazuar në këtë gjendje, MKPT-ja aty për aty ka rekomanduar që mjete për rruajtje dhe ushqimi t'i shërbehen pa mjete që rrezikojnë atë apo të tjerët.
37. Nga dosjet shëndetësore vërehet se shërbimet psikiatrike janë duke u realizuar, por po ashtu është vërejtur përdorimi i shtuar i terapive psikotike. Sa i përket ofrimit të shërbimeve psikologjike, MKPT-ja konsideron se numri i të burgosurve në QKD është tepër i madh për t'u mbuluar me shërbime psikologjike vetëm prej një psikologu. MKPT-ja inkurajon DShB-në të bëjë zgjidhje për angazhimin e psikologut shtesë në QKD.
38. Sa i përket vdekjeve në QKD, MKPT-ja ka vërejtur se në vitin 2020 kishte 8 raste të tilla: 2 vetëvarje dhe 6 nga sëmundjet kronike, nga të cilët dy janë konfirmuar edhe me COVID-19, ndërsa njëri i dyshuar, por jo rast i konfirmuar me COVID-19. Ndërsa në vitin 2021, deri më tani është 1 rast me COVID-19.
39. Autopsia bëhet vetëm te rastet e dyshimta dhe atyre që ndodhin brenda 24 orësh dhe të cilat janë të papritura. Kopja e raportit të autopsisë nuk i dorëzohet shërbimit shëndetësor për t'u vendosur në dosje të pacientit.

#### **Parandalimi i vetëvrasjeve dhe i vetëlëndimeve**

40. MKPT-ja vëren se LESP-ja përcakton se një ndër qëllimet e kontrolleve të hershme mjekësore është edhe parandalimi i vetëvrasjeve dhe i vetëlëndimeve. Më tej LESP-ja përcakton se nëse personi i dënuar bën përpjekje për ta lënduar veten, ose të bëjë vetëvrasje, një ekip profesional shumëdisiplinor ndërmerr veprime të nevojshme për t'i dalë në ndihmë atij në mënjanimin e shkaqeve që e shtyjnë atë në tentimin për të ndërmarrë një veprim të tillë.<sup>10</sup>
41. Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur se shërbimi shëndetësor për t'i parandaluar vetëvrasjet dhe vetëlëndimet ndërmerr veprimet përmes kontrolleve mjekësore menjëherë pas pranimit të të burgosurit, të cilat bazohen në vlerësimin e gjendjes shëndetësore dhe pastaj duke vazhduar me vlerësimin psikologjik, si dhe sigurimi i aktiviteteve sportive dhe angazhimi në punë nga drejtoria e QKD-së. MKPT-ja, nga dokumentacioni i analizuar, ka vërejtur se në vitin 2020 janë evidentuar 43 vetëlëndime, 55 lëndime trupore, 8 tentim vetëvrasje. Dy nga këto tentim vetëvrasje kanë përfunduar me fatalitet.

#### **Sëmundjet ngjitëse**

42. Standardet e KPT-së përcaktojnë: *“Një shërbim i kujdesit shëndetësor në burg duhet të sigurojë që të qarkullohet rregullisht si te personeli i burgut edhe te të burgosurit informacion për sëmundjet e transmetueshme (veçanërisht për hepatitin, AIDS, tuberkulozin, infeksionet dermatologjike). Aty ku është e përshtatshme, duhet të kryhet*

---

<sup>10</sup> Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 47.



*kontroll mjekësor te ata me të cilët ka kontakte të rregullta (të burgosur të tjerë, personel burgu, vizitorë) një i burgosur i veçantë.”<sup>11</sup>*

43. KPT-ja më tej përcakton: “Përsa i përket, posaçërisht AIDS, duhet të ofrohet këshillim i përshtatshëm si përpara dhe, në se është e nevojshme, pas çdo testi kontrolli. Personeli i burgut duhet të trajnohet vazhdimisht për masat parandaluese që duhen marrë dhe qëndrimet që duhen mbajtur ndaj pozitivitetit në HIV dhe t’u jepen udhëzime të përshtatshme lidhur me mos-diskriminimin dhe konfidencialitetin.”<sup>12</sup>
44. Gjatë vizitës në QKD, MKPT-ja ka vërejtur se u regjistrua një rast me SST(AIDS) dhe 3 raste me Hepatit-C pozitiv, të cilët menaxhohen nga personeli i trajnuar në bashkëpunim me Klinikën Infektive. Lidhur me këtë sëmundje, është bërë edhe vaksinimi i personelit mjekësor dhe rivaksinimi i atyre të vaksinuar në Institutin Kombëtarë të Shëndetësisë Publike të Kosovës (më tej: IKShPK), ndërsa të gjithë të punësuarit e rinj janë të obliguar vetë të vaksinohen në IKShPK.
45. Po ashtu, DShB-ja, lidhur me trajtimin dhe parandalimin e TBC-së dhe HBV&HCV, ka lidhur marrëveshje me OJQ “KEA” për monitorim, trajnim, trajtim dhe mbështetje profesionale gjithëpërfshirëse. MKPT-ja po ashtu ka vërejtur se prezervativët vendosen në hapësirat e shërbimit shëndetësor në vende të cilat ofrojnë konfidencialitet për të burgosurit të cilët i marrin.

#### **Kontrollimi sistematik i përdorimit/abuzimit të drogës, alkoolit dhe duhanit**

46. Kontrollimi sistematik i përdoruesve dhe abuzuesve të drogës, alkoolit dhe duhanit bëhet me identifikimin e tyre me rastin e pranimit, duke vazhduar përmes monitorimit të mëtejshëm që nënkupton informimi lidhur me pasojat e përdorimit, trajtimit me terapi adekuate e cila duhet të përdoret vazhdimisht dhe përmes trajnimit të personelit për të punuar me këtë kategori. Po ashtu, duke bashkëpunuar me institucionet tjera të cilat merren me trajtimin e kësaj kategorie.
47. Bazuar në dokumentacionin e analizuar, MKPT-ja vëren se në vitin 2020 janë regjistruar si përdorues të duhanit 494 të burgosur, kurse në janar të vitit 2021 janë regjistruar 38 të tillë. Në vitin 2020 janë evidentuar 226 abuzues të alkoolit, kurse në janar 2021 janë regjistruar 16 të tillë. Sa i përket abuzimit me drogë, në vitin 2020 janë regjistruar 153 të tillë, kurse në muajin janar 2021 janë regjistruar 19 abuzues të drogës.
48. MKPT-ja ka vërejtur se në dispozicion të të burgosurve është programi me metadon, i cili realizohet sipas protokollit të përcaktuara në Procedurën Standarde të Veprimt (më tej: PSV); i trajnimeve dhe mbështetjes e cila ofrohet nga Qendra për këshillim dhe trajtim të varësisë “Labirint” për drogat dhe trajtimin e përdoruesve në pajtim me protokollet nacionale për të burgosur të sapo pranuar, të cilët identifikohen si të tillë, si dhe për trajtim të atyre të cilët dalin nga burgu dhe vazhdojnë me program të metadonit.
49. Sa i përket furnizimit me barna, MKPT-ja ka vërejtur se ka furnizim të mjaftueshëm me barna. Ndërsa në fazën e hershme të pandemisë COVID-19 ka pasur mungesa të rralla dhe të përkohshme të barnave të caktuara. Gjatë vizitës nuk janë gjetur barna me afat të

<sup>11</sup> Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Pjesë nga raporti i 3-të i Përgjithshëm, publikuar në vitin 1993. Shih në: <https://rm.coe.int/16806ce91b> (11.3.2021)

<sup>12</sup> Po aty.

skaduar. Të gjitha barnat me afat të skaduar janë larguar dhe paketuuar për asgjësim dhe janë vendosur në depo. Shpërndarja e ilaçeve bëhet nga infermierët dhe bëhet në mënyrën që ofron konfidencialitet.

50. Sa u përket të dënuarve me masë disiplinore të vetmisë, MKPT-ja ka vërejtur se personeli mjekësor nuk merr pjesë në vendimmarrje me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj të burgosurit, por vetëm raporton për gjendjen shëndetësore të të burgosurit në fjalë. Bazuar në dokumentacionin relevant, mjeku viziton çdo dy-tri ditë të burgosurin e ndëshkuar me masë disiplinore të vetmisë, kurse infermieri e viziton së paku një herë në ditë dhe ia mat parametrat vital.
51. Monitorimi dhe inspektimi i zbatimit të dispozitave nga fusha e shëndetësisë bëhet nga organet e Ministrisë së Shëndetësisë - Inspektorati, MKPT-ja, OJQ-të të cilat nënshkruajnë marrëveshje me organet kompetente, si dhe mekanizmat ndërkombëtarë monitorues, siç janë: KPT-ja, Kryqi i Kuq Ndërkombëtar etj. Sa u përket regjistrave, MKPT-ja ka vërejtur se shërbimi shëndetësor përdor regjistra fizikë dhe elektronikë.
52. Edhe gjatë kësaj vizite, MKPT-ja ka vërejtur se spitali, edhe pse ka pasur disa rinovime të dysHEMEVE të pjesës së stacionarit ku qëndrojnë pacientët, ende nuk i plotëson kushtet për trajtim adekuat të personave të hospitalizuar. Spitali është i ndarë në dy reparte: Reparti Psikiatrik dhe Reparti i Sëmundjeve Organike.
53. MKPT-ja ka vërejtur se Pavijoni 7 është pjesë e shërbimit shëndetësor ku janë të vendosur të burgosurit me probleme të ndryshme, por lehtë të menaxhueshëm, por kanë nevojë për përkujdesje shëndetësore. Tash për tash janë të vendosur 15 persona dhe të gjithë janë me terapi e cila i përgjigjet diagnozës që kanë.

#### **Rëndësia e kontroleve mjekësore të të burgosurve të sapopranuar**

54. KPT-ja vazhdimisht thekson rëndësinë e kontrollimit mjekësor të të burgosurve të sapopranuar, veçanërisht në institucionet që përbëjnë si pikë hyrjeje në sistemin e burgjeve. Një kontrollim i tillë është esencial, veçanërisht për t'i parandaluar vetëvrasjet dhe përhapjen e sëmundjeve ngjitëse (siç janë tuberkulozi, hepatiti B/C, HIV).
55. Sipas KPT-së, shërbimet mjekësore të burgut mund të japin kontribut domethënës në parandalimin e keqtrajtimit fizik gjatë periudhës menjëherë para burgosjes, domethënë në periudhën kur personat janë në mbajtje nga agjencitë e zbatimit të ligjit, përmes regjistrimit sistematik dhe me kohë të lëndimeve dhe, kur kjo është e përshtatshme, përmes sigurimit të informatave për autoritetet relevante.<sup>13</sup>
56. LESP-ja<sup>14</sup> dhe Praktika Standarde e Veprimeve (PSV)<sup>15</sup> e DShB-së përcaktojnë obligimin e autoriteteve që i burgosuri i sapopranuar t'i nënshtrohet kontrollit mjekësor brenda 24 orëve nga momenti i pranimit.
57. Obligime të tilla përcaktohen edhe me aktet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve, siç janë: Rregullat e Mandelës<sup>16</sup>, Rregullat Evropiane të Burgjeve<sup>17</sup> dhe Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria.<sup>18</sup>

<sup>13</sup> Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti i 26-të i Përgjithshëm, paragrafi 72, në: <https://rm.coe.int/168070d0c8>.

<sup>14</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 31.

<sup>15</sup> Praktika Standarde e Veprimeve, pika 1. Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1.-Praktikat-Standarde-te-Vepimit-n%C3%AB-DShB.pdf>.

58. Bazuar në pohimet e të burgosurve dhe në dokumentacionin relevant mjekësor, të burgosurit e sapoprnuar kontrollohen brenda afatit prej 24 orësh nga momenti i pranimit në QKD. Këto kontrolle nënkuptojnë një kontroll të përgjithshme, sipas PSV-së së DShB.

### **Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore**

59. Bazuar në informatat nga stafi i shërbimit shëndetësor dhe nga intervistat me të burgosurit, shërbimet shëndetësore, në përgjithësi, jepen pa praninë e zyrtarëve korrektues.

60. Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore parashihet me PSV-në,<sup>19</sup> e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë; me LESP-në<sup>20</sup>; me standardet e KPT-së;<sup>21</sup> si dhe me aktet ndërkombëtare, siç janë: Rregullat e Mandelës<sup>22</sup> dhe Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria.<sup>23</sup>

61. Për më shumë, edhe standardet e KPT-së përcaktojnë se të gjitha ekzaminimet mjekësore të të burgosurve duhet të kryhen në atë mënyrë që të mos shihen dhe të mos dëgjoen nga zyrtarët korrektues, përveç në rastet kur mjeku e kërkon një gjë të tillë.

62. Neni 25, paragrafi 3, i Udhëzimit Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese shprehimisht përcakton: *“Mjeku bënë vizitën mjekësore në kushte të konfidencialitetit mjekësor dhe normave etike profesionale.”*

### **Personeli i Qendrës Korrektuese në Dubravë**

63. Edhe gjatë kësaj vizite, MKPT-ja ka vërejtur mungesë të personelit korrektues, të punëtorëve socialë dhe të psikologëve. Po ashtu, gjatë vizitës, MKPT-ja ka marrë shumë ankesa edhe nga personeli korrektues lidhur me numrin e vogël të zyrtarëve korrektues në raport me të burgosurit dhe për kushtet e tjera të punës. Një nga ankesat e shumta është edhe mosfurnizimi me uniforma dhe pajisje të tjera të domosdoshme për ta kryer punën e tyre.

### **Shërbimi social në QKD**

64. Gjatë vizitës në QKD, MKPT-ja ka marrë ankesa për shërbime joefektive sociale nga punëtorët socialë. Lidhur me këtë, MKPT-ja ka kërkuar komentet e drejtorit të QKD-së. Sipas drejtorit, nga data 8 mars 2021, të gjithë zyrtarët për punë sociale do të jenë të pranishëm gjatë gjithë javës në pavijone. MKPT-ja mirëpret këtë vendim të drejtorit të

---

<sup>16</sup> Rregullat e Mandelës, Rregulli 34. Shih në: [https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E\\_ebook.pdf](https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E_ebook.pdf).

<sup>17</sup> Këshilli i Evropës, Rekomandimi (2006) 2 i Këshillit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve, pika 42.1. Shih në: <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016804c221d>.

<sup>18</sup> Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria, pika 27, në: [https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/res45\\_113.pdf](https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/res45_113.pdf).

<sup>19</sup> Praktika Standarde e Veprimit, pika 11. Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1.-Praktikat-Standarde-te-Veprimit-n%C3%AB-DShB.pdf>.

<sup>20</sup> Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 49.

<sup>21</sup> Standardet e KPT-së, publikuar në vitin 2018, paragrafët 50 dhe 51. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806ce943>.

<sup>22</sup> Rregullat e Mandelës, Rregulli 26, pika 2, në: [https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E\\_ebook.pdf](https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E_ebook.pdf).

<sup>23</sup> Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria, pika A, Rregulli 19, në: [https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/res45\\_113.pdf](https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/res45_113.pdf).

QKD-së. Megjithatë, numri i punëtorëve socialë mbetet shumë i vogël në krahasim me numrin e të burgosurve dhe ata vazhdojnë të jenë të mbingarkuar me punë administrative.

### **Masat disiplinore**

65. Sipas legjisllacionit në fuqi, dënimet disiplinore që mund t'u shqiptohen të dënuarve janë: qortimi, heqja e beneficionit të caktuar, urdhri për kompensim dhe vetmia.<sup>24</sup> Kurse në rastin e të paraburgosurve mund të shqiptohen dënimet si në vijim: kufizimi apo ndalimi i vizitave apo i korrespondencës, përveç kontakteve me avokatin mbrojtës, me Avokatin e Popullit dhe me misionet diplomatike. Gjatë vizitës, me qëllim të analizimit të gjendjes në këtë aspekt, MKPT-ja ka analizuar disa vendime të drejtorit të QKD-së, me të cilat të burgosurve të caktuar u janë shqiptuar masa të ndryshme disiplinore, përfshirë edhe masën disiplinore të vetmisë.
66. Bazuar në statistikat e QKD-së, masa disiplinore e vetmisë deri më tani (në muajt janar dhe shkurt 2021) u shqiptua në 34 raste. MKPT-ja ka vërejtur se QKD-ja mban regjistër për masat e shqiptuara disiplinore, ku shënohen të dhëna lidhur me masën e shqiptuar, arsyen, kohën e shqiptimit dhe kohën e mbarimit.
67. Po ashtu, këto vendime disiplinore u dorëzohen edhe të burgosurve dhe përmes të njëjtave ata njoftohen për mjetet juridike në dispozicion, në qoftë se janë të pakënaqur me masën disiplinore të shqiptuar.

### **Kontakti me botën e jashtme**

68. Legjisllacioni në fuqi<sup>25</sup>, në rastin e personave të dënuar, përcakton se të burgosurit e dënuar kanë të drejtë të pakufizuar për korrespondencë (që u nënshtrohen përjashtimeve të caktuara), kanë të drejtë për një vizitë në muaj, e cila zgjat më së paku një orë, si dhe për vizitë nga fëmijët dhe bashkëshortet e tyre, së paku një herë në 3 muaj, me kohëzgjatje minimale prej tri orësh.
69. Përveç kësaj, ata kanë të drejtë për të bërë thirrje telefonike. Bazuar në intervistat me të dënuarit, atyre u mundësohen vizitat familjare, vikendet, si dhe kontaktet me familjet e tyre me SKYPE. MKPT-ja ka vërejtur se komunikimi me SKYPE është mirëpritur nga të burgosurit, sidomos nga të burgosurit shtetas të huaj. Prandaj MKPT-ja inkurajon QKD-në që të vazhdohet me këtë lloj komunikimi.
70. Lidhur me thirrjet telefonike, Udhëzimi Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese<sup>26</sup> përcakton se i dënuari ka të drejtë për biseda telefonike me anëtarët e familjes së ngushtë dhe me personat e tjerë. Sipas këtij udhëzimi, biseda telefonike e personit të dënuar dhe i të paraburgosurit nuk mund të jetë më e gjatë se 15 minuta.
71. Të dënuarit gëzojnë të drejtën për telefonata, varësisht nga regjimi, ndërsa në pavijone të caktuara telefonatat janë të pakufizuara. Në rastin e të paraburgosurve, neni 200 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës përcakton se të paraburgosurit mund të pranojnë vizita “*brenda kufijve të rregullave të qendrës së paraburgimit*” bazuar në lejen e gjyqtarit të procedurës paraprake dhe nën mbikëqyrjen e tij.

<sup>24</sup> Paragrafët nga 101 deri në 113 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

<sup>25</sup> Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nenet 62-65.

<sup>26</sup> Udhëzimi Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, neni 54.

72. Më tej ky kod përcakton se korrespondenca dhe vizitat e tjera i nënshtrohen vendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake. Bazuar në intervistat me të paraburgosurit, del se atyre u mundësohen dy vizita në muaj sipas lejes së gjykatës dhe një vizitë shtesë nga Drejtoria, bazuar në kërkesën e parashtruar nga i paraburgosuri në rrethana të caktuara.
73. Avokati i Popullit ose përfaqësuesit e tij mund t'i vizitojnë të paraburgosurit dhe të korrespondojnë me ta pa paralajmërim paraprak dhe pa mbikëqyrjen e gjyqtarit të procedurës paraprake, të gjyqtarit të vetëm gjykues apo të kryetarit të trupit gjykues ose të personave të tjerë të emëruar nga gjyqtari i tillë. Letrat e të paraburgosurit dërguar Institucionit të Avokatit të Popullit nuk mund të kontrollohen. Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij mund të komunikojnë gojarisht ose me shkrim në mënyrë konfidenciale me të paraburgosurit. Po ashtu, të dënuarit mund t'i drejtohen MKPT-së së Avokatit të Popullit edhe përmes telefonit.
74. Në rastin e shtetasve të huaj, atyre u ofrohet mundësia që, me shkrim ose me gojë, të kontaktojnë me përfaqësinë diplomatike, apo me zyrën përkatëse të shtetit shtetësinë e të cilit e ka ai/ajo.<sup>27</sup> Gjatë vizitës, MKPT-ja ka intervistuar disa shtetas të huaj, të cilët nuk patën asnjë ankesë sa i përket trajtimit në QKD, përkundrazi, ata u shprehën në favor të marrëdhënieve mjaft pozitive, si me zyrtarët korrektues, ashtu edhe me të burgosurit e tjerë.

### **Hapësirat ku pranohen vizitat**

75. Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vizituar edhe hapësirat ku pranohen vizitat familjare. Kushtet në këto hapësira mbeten në nivel të kënaqshëm dhe nuk ka barriera, të cilat do ta pengonin kontaktin e drejtpërdrejtë ndërmjet familjarëve dhe të të burgosurit. Për më shumë, sallat ku zhvillohen vizitat familjare u stolisën me piktura të ndryshme nga të burgosurit, të cilat tani kanë një pamje të bukur vizuale.

### **Çështje të ndërlidhura me sigurinë**

76. MKPT-ja gjatë vizitës ka vërejtur se dhoma e kontrollit në përgjithësi është e pajisur mirë me kamera të sigurisë, edhe pse disa nga to nuk ishin në funksion. Mirëpo, në disa pavijone janë instaluar kamera të sigurisë me rezolucion HD dhe janë të tipit rrotullues, të cilat ofrojnë pamje të kualitetit të lartë.
77. MKPT-ja mirëpret këtë zhvillim. MKPT-ja përsëri inkurajon autoritetet e QKD-së që t'i pajisin me kamera të sigurisë të gjitha korridoret e pavijoneve dhe të hapësirave të jashtme, të cilat, sipas KPT-së, në fakt përbëjnë një nga garancitë për mbrojtje nga keqtrajtimi, por përbëjnë edhe garanci për zyrtarët korrektues kur ata akuzohen rrejshëm.<sup>28</sup>

### **Incidentet ndërmjet të burgosurve**

78. Bazuar në dokumentacionin relevant, MKPT-ja ka vërejtur se gjatë këtij viti, respektivisht në periudhën janar-shkurt 2021, janë regjistruar 16 incidente ndërmjet të burgosurve. Gjatë vizitës, MKPT-ja ishte dëshmitare e një incidenti ndërmjet dy të burgosurve. MKPT-ja ka vërejtur se reagimi i personelit korrektues ishte i shpejtë dhe profesional dhe ky konfrontim fizik u ndërpre brenda disa sekondash.

<sup>27</sup> Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 33, paragrafi 1.

<sup>28</sup> KPT-ja, raporti për vizitën në Irlandë në vitin 2010, paragrafi 18.

79. Po ashtu, menjëherë u ndërmorën masa adekuate për të parandaluar takimin dhe konfrontimin e serishëm ndërmjet dy të burgosurve në fjalë. MKPT-ja ka vërejtur se këto incidente janë evidentuar në formularë përkatës, sipas nevojës është ofruar ndihma mjekësore dhe janë ndërmarrë veprimet e parapara me LESP.

### **Procedurat e ankesave**

80. Sistemi efektiv i parashtrimit të ankesave është garancia themelore kundër keqtrajtimit në burgje dhe në qendra të paraburgimit. Personat e vendosur në këto qendra duhet të kenë mundësi për të parashtruar ankesë brenda burgut apo për t'i parashtruar ankesë qendrës së paraburgimit ku është vendosur dhe në mënyrë konfidenciale t'u mundësohet qasja tek autoriteti i duhur.

81. Neni 91 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton në hollësi procedurën sipas së cilës të paraburgosurit dhe të dënuarit mund t'i drejtohen me ankesë apo me lutje drejtorit të një institucioni të caktuar të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Procedura përfshin edhe afatet për përgjigje nga drejtori dhe mundësinë që ankesa t'i drejtohet një autoriteti tjetër, që në rastin e tanishëm janë Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Korrektues dhe Ministria e Drejtësisë.<sup>29</sup>

82. MKPT-ja ka vërejtur se në dispozicion të të burgosurve në QKD janë kutitë e ankesave, të vendosura nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, nga DShB-ja dhe nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit mund të hapen vetëm nga personeli i këtij institucioni, gjë që për ankuesit ofron konfidencialitet në parashtrimin e ankesës.

83. Gjatë vizitës, MKPT-ja mori ankesa nga disa të burgosur për mospërgjigje nga drejtori i QKD-së dhe i ShKK-së në kërkesat dhe ankesat e tyre. Lidhur me këtë, MKPT-ja ka kërkuar komentet e drejtorit të QKD-së. Sipas drejtorit, bëhen përpjekje maksimale për ta përmbushur këtë obligim ligjor dhe se zyrtarëve kompetentë serish do t'u dërgohen udhëzime të qarta që, pa vonesa, ta plotësojnë këtë obligim ligjor. MKPT-ja përmes vizitave përcjellëse do ta monitorojë këtë çështje.

84. Në bazë të të gjeturave dhe të konstatimeve të MKPT-së gjatë vizitës, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17, paragrafi 7, të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i

### **REKOMANDON**

#### **Ministrisë së Drejtësisë:**


- **Të pajisen me librezë sanitare tërë personeli dhe të burgosurit e angazhuar në punë në kuzhinë.**
- **Të pajiset kuzhina me materiale të mjaftueshme higjienike (dezinfektues, dorëza etj.).**
- **Të evitohen mangësitë në pajisjet teknike në kuzhinë dhe në lavanteri.**

<sup>29</sup> Neni 91, paragrafi 4 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton: "Në ankimin e paraqitur drejtori i institucionit korrektues do të përgjigjet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, ndërsa Zyra Qendrore e Shërbimit Korrektues në afat prej tridhjetë (30) ditësh. Në ankimin me shkrim do të jepet përgjigja në formën me shkrim."

- Të kryhen rinovime sipas vlerësimit dhe nevojës në pavijonet e caktuara (shih paragrafin 19 të këtij raporti).
- Të rritet numri i personelit korrektues, i punëtorëve socialë dhe i personelit tjetër, sipas vlerësimit dhe nevojës.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,



Naim Qelaj  
Avokat i Popullit